European Bank
for Reconstruction and Development

# Dokumenti i Përmbledhjes së Projektit

| | |
|---|---|
| Emri i Projekti: | Programi i Infrastrukturës dhe Zhvillimit te Turizmit në Shipëri |
| Vendi: | Shqipëri |
| ID të projektit: | 49351 |
| Sektori Biznesit: | Infrastruktura Bashkiake & Mjedisore |
| Shtetëror/Privat: | Sektori Shtetëror |
| Data e Parashikuar e Bordit | Me publikimin në faqen e Bankës në internet, gjenerohet automatikisht nga DTM. Ju lutem sigurohuni që DTM është i përditësuar përpara dërgimit të PSD për publikim në internet. |
| Statusi: | Ka kaluar fazën e miratimit të Konceptit |
| Data e shpalosjes së DPP:<br>Data updatetimit të DPP: | Kjo plotësohet nga redaktori i PSD në Departamentin e Komunikimit |
| Përshkrimi dhe objektivat e projektit: | <u>Përshkrimi i Projektit:</u><br><br>Dhënia e një kredie sovrane Republikës së Shqipërisë në shumën prej deri 60 milion Euro, e ndarë në dy transhe prej 30 milion Euro secili, për të financuar respektivisht: (i) projekte infrastrukture që mundësojnë zhvillimin e turizmit dhe (ii) projekte infrastrukture të përgjithshme bashkiake dhe transporti, (“Programi i Infrastrukturës dhe Zhvillimit të Turizmit në Shqipëri“, “PIZHT“ ose “Projekti“). Gjithashtu, Banka do të përpiqet të mundësojë financim ose ndarje risku nëpërmjet bankave lokale tregtare, si edhe shërbim këshillimi, për të mbështetur ndërmarrjet mikro dhe SME-të aktive në të gjithë ciklin e sektorit të turizmit.<br><br>Investimet në infrastrukturë që mundëson zhvillimin e turizmit do të kryhen në rajonet e Beratit, Korçës, Fierit dhe Shkodrës (“Rajonet e Përcaktuara“), ndërsa investimet në infrastrukturën e përgjithshme bashkiake dhe të transportit do të kryhen në të gjithë vendin, përfshirë dhe Rajonet e Përcaktuara.<br><br>PIZHT do të bashkëfinancohet me një grant nga Bashkimi Europian (BE) prej 40 milion Euro i cili do të përdoret, ndër të tjera, për rehabilitimin e objekteve të trashëgimisë kulturore dhe zonavë të trashëgimisë natyrore, i cili do të vihet në dispozicion nëpërmjet fondit IPA (Instrument for Pre-Accession).<br><br><u>Objektivat e Projektit:</u><br><br>1. Shtimi i konkurueshmërisë së sektorit shqiptar të turizmit nëpërmjet një qasje tërësore duke përfshirë zhvillimin e infrastrukturës, rehabilitimin e zonave të trashëgimisë kulturore dhe natyrore dhe mbështetjen e SME-ve.<br>2. Përmirësimi i infrastrukturës bashkiake dhe mjedisore në të gjithë vendin dhe i lidhjeve rajonale të transportit për të mundësuar akses më të sigurtë në qendrat ekonomike në të gjithë vendin, përfshirë dhe në Rajonet e Përcaktuara, dhe |

| | |
|---|---|
| | për të përmirësuar aksesueshmërine në zona të caktuara turistike dhe fshatra turistikë në këto rajone. |
| Ndikimi në tranzicion : | - Projekti do të rrisë konkurueshmërinë e turizmit në brendësi të vendit në mënyrë që Shqipëria të mund të zhvillojë potenciale të rëndësishme edhe përtej destinacioneve ekzistuese bregdetare. Kjo do të arrihet nëpërmjet investimeve në infrastrukturë bashkiake dhe të transportit që lidhet me turizmin si dhe nëpërmjet mbështetjes së SME-ve të përfshira në të gjithë ciklin e sektorit të turizmit.<br><br>PIZHT do të kontribuojë në përmirësimin e cilësisë dhe ndërlidhshmërisë së infrastrukturës nëpërmjet një infrastrukture lokale të zhvilluar, përfshirë rrugët lokale për një ndërveprim ekonomik më eficent dhe efektiv.<br><br>- Projekti do të kontribuojë në promovimin e praktikave gjithëpërfshirëse të prokurimit për të mundësuar trajnim gjatë punës për të rinjtë gjatë fazës së ndërtimit duke i angazhuar kontraktorët e nën-projekteve të infrastrukturës në ofrimin e trajnimeve në terren për një numër të rinjsh. |
| Klienti: | Huamarrësi është Republika e Shqipërisë e përfaqësuqar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë. Klienti dhe Agjencia Ekzekutuese është Fondi Shqiptar i Zhvillimit (FSHZH) i cili është përgjegjës për manaxhimin e projekteve të infrastrukturës lokale dhe rajonale si edhe mbështetjen e njësive qeverisëse vendore në fuqizimin e tyre institucional. |
| Financimi I EBRD: | Kredi sovrane ne shumën prej deri në 60 milion Euro. |
| Kostoja totale e projektit: | Kostoja totale e vlerësuar e Projektit është rreth 113.3 milion Euro. |
| Ndikimi mjedisor: | I kategorizuar Ekzaminim Fillestar Mjedisor dhe Social (EFMS) (Politika Mjedisore dhe Sociale (PMS) 2014). Nën-projektet për financim nën këtë Projekt nuk janë përcaktuar ende. Parashikohet që nën-projektet të konsistojnë kryesisht në rehabilitime rrugësh, menaxhim mbetjesh të ngurta, ndriçim rrugësh, rinovim të sistemeve të ujësjellës-kanalizimeve, dhe rehabilitim të zonave të trashëgimisë kulturore dhe natyrore. Kategoria e Projektit dhe qëllimi i shqyrtimit mjedisor dhe social do të përcaktohen sapo të jetë konfirmuar lista indikative e nën-projekteve. Çështjet e trashëgimisë kulturore do të ekzaminohen specifikisht nëse do ketë nën-projekte që lidhen me vendndodhje dhe/ose çështje të tilla.<br><br>Ky DPP do të përditësohet kur të njihen rezultatet e shqyrtimit mjedisor. |
| Bashkëpunimi teknik | Si pjesë e Projektit janë parashikuar edhe programet e mëposhtme të Bashkëpunimit Teknik:<br>• Program zhvillimi të kapaciteteve për të rritur potencialet e turizmit të bashkive, bizneseve të vogla dhe shoqatave të turizmit;<br>• Program për përmirësimin e aftësive huamarrëse në nivel bashkiak për Korçën, Beratin, Shkodrën dhe Fierin;<br>• Mbështetje për zbatimin e projekteve për FSHZH gjatë procesit të tenderimit, zbatimit të projektit dhe mbikqyrjes së punimeve;<br>• Inxhinier i Monitorimit për llogari të Huadhënësve<br>• Konsulent për përfshirje ekonomike për të vlerësuar, zhvilluar dhe zbatuar praktika prokurimi përfshirëse për një pjesë të nën-projekteve, për të ofruar mundësi efektive trajnimi në punë të të rinjve gjatë aktiviteteve të ndërtimit që lidhen me investimet në infrastrukturë.<br>• Analizë teknike dhe financiare e nën-projekteve<br>• Shqyrtimi i ndikimeve mjedisore dhe sociale |

| | |
|---|---|
| | Për mundësi konsulence për projektet e financuara nga fondet e bashkëpunimit teknik, shiko procurement of consultants. |
| Informacioni mbi kontaktin e shoqërisë | Benet Beci<br>adf@albaniandf.org<br>Tel: +355 4 2235 597<br>Fax: +355 4 2234 885<br>www.albaniandf.org |
| Mundësitë për prokurim ose tenderim: | Shiko EBRD Procurement<br>Kërkesat: Tel: +44 20 7338 6794; Fax: +44 20 7338 7472<br>Email: procurement@ebrd.com |
| Pyetje të përgjithshme: | Pyetjet mbi projektet e BERZH që nuk lidhen me prokurimin:<br>Tel: +44 20 7338 7168; Fax: +44 20 7338 7380<br>Email: projectenquiries@ebrd.com |